

**SKEMA E VLERËSIMIT
PROVIMI I LIRIMIT 2010 – Matematikë, Sesion I**

I. Përgjigjet e sakta të kërkesave 1 – 13. Vlerësimi për çdo përgjigje të saktë është 1 pikë.

1C	2B	3B	4B	5A	6A	7D	8B	9C	10D	11B	12A	13C
-----------	-----------	-----------	-----------	-----------	-----------	-----------	-----------	-----------	------------	------------	------------	------------

II. Skema e vlerësimit më pikë të përgjigjeve për kërkesat me nr. 14 – 25 të testit

- | | | |
|--------------|--|--|
| 14 | - përkthen me simbole “numrit 18 i zbritet numri n” ose “rezultati është katër më i vogël se n”
- ndërton ekuacionin e duhur për gjetjen e n-së
- zgjidh ekuacionin | 1 pikë
1 pikë
1 pikë |
| 15 a) | - sjell inekuacion në trajtën $ax < b$ ($ax > b$)
- zgjidh inekuacionin në R | 1 pikë
1 pikë |
| b) | - zgjidh inekuacionin në N | 1 pikë |
| 16 | - me metodën e mbledhjes ose zëvendësimit kryen shndërrime të njëvlershme deri në ekuacion me një ndryshore
- gjennjërën ndryshore
- gjen zgjidhjen e sistemit

Ose me metodë grafike
- ndërton një rreth drejtëz
- ndërton drejtëzën tjetër
- gjen pikën e prerjes dhe zgjidhjen si koordinata të pikës së prerjes | 1 pikë
1 pikë
1 pikë

1 pikë
1 pikë
1 pikë |
| 17 | - jep barazimin $\vec{b} = k \cdot \vec{a}$ ose formën e njëvlershme të tij
- gjen vlerën e k
- gjen vlerën e x-it | 1 pikë
1 pikë
1 pikë |
| 18 | - shpreh me simbole matematike përqindjen e vajzave para ose pas shtimit me 5
- ndërton barazimin e duhur në bazë të të dhënave
- gjen numrin e djemve | 1 pikë
1 pikë
1 pikë |
| 19 | - tregon që abshisa e kulmit të parabolës është $m = 1$
- bën zëvendësimet e duhura për gjetjen e ordinatës së kulmit
- gjen ordinatën e kulmit | 1 pikë
1 pikë
1 pikë |
| 20 | - gjen numrin e hapësirës së rezultateve
- gjen $n(A)$
- gjen probabilitetin e ngjarjes A | 1 pikë
1 pikë
1 pikë |
| 21 | - ndërton një barazim për gjetjen e njërës brinjë të pistës katrore
- gjen perimetrin e pistës katrore të madhe
- gjen kohën që përshkon pistën katrore të madhe | 1 pikë
1 pikë
1 pikë |

- 22 - shkruan një barazim raportesh të brinjëve homologe 1 pikë
 - gjen brinjë anësore të trekëndëshit me bazë 10 cm 1 pikë
 - gjen perimetrin e trekëndëshit me bazë 10 cm 1 pikë
- 23 - bën figurën (rrethin dhe tangjenten ndaj tij në pikën A) 1 pikë
 - argumenton që këndi OAP është i drejtë në bazë të vetisë që tangjentja është pingule me rrezet e rrethit në pikën e saj të takimit 1 pikë
 - gjen hipotenuzën OP me anë të teoremës së Pitagorës 1 pikë
- 24 a) - gjen lartësinë e paralelogramit 1 pikë
 - gjen syprinën e paralelogramit 1 pikë
- 24 b) - gjen abshisën e pikës C 1 pikë
 - gjen ordinatën e pikës C 1 pikë
- 25 - bën figurën 1 pikë
 - argumenton që përgjysmorja e këndit A e ndan brinjën BC me anë të pikës D 1 pikë
 - në segmente që janë në raporin 7:25 1 pikë
 - gjen $CD = 21/4$ 1 pikë
- ose,
 Duke ndërtuar pingulen nga pika D mbi AB dhe shënon E këmbën e pingules:
- tregon që trekëndëshi ADC është i barabartë me trekëndëshin ADE 1 pikë
- ndërton barazimin $S_{\triangle ABC} = S_{\triangle ACD} + S_{\triangle ADB}$ ose $\frac{7x}{2} + \frac{25x}{2} = \frac{7 \cdot 24}{2}$
- ku $x = DE = DC$ 1 pikë
- gjen x 1 pikë